



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**  
**DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT**

Nr. 1064/1 prot.

Tiranë, më 04.05.2026

Lënda: Dhënie mendimi lidhur me projektvendimin *“Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të regjistrit kombëtar të aktivitetit të licensuar dhe të lejuar të bimës së Cannabis-it”*.

**MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE**

**Tiranë**

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim *“Zyra e Komisionerit”*) ka administruar shkresën tuaj nr. 2089 prot., datë 14.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 1064 prot., datë 16.04.2026, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin *“Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të regjistrit kombëtar të aktivitetit të licensuar dhe të lejuar të bimës së Cannabis-it”* (në vijim *“projektvendimi”*), si dhe relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i materialit të vendosur në dispozicion, vërejmë se projektvendimi ka si qëllim, krijimin dhe rregullimin e funksionimit të bazës së të dhënave shtetërore *“Regjistri Kombëtar i Aktivitetit të Licensuar dhe të Lejuar të bimës së cannabis-it”* si një instrument qendror për administrimin, monitorimin dhe kontrollin e të gjitha proceseve që lidhen me kultivimin, përpunimin dhe qarkullimin e bimës së cannabis-it për qëllime mjekësore dhe industriale. Krijimi i regjistrit synon të garantojë transparencë, gjurmueshmëri të plotë dhe rritje të efikasitetit institucionale në zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi.

Zyra e Komisionerit konstaton se, përgjithësisht projektvendimi i referohet rregullave dhe parimeve bazë mbi mbrojtjen e të dhënave personale, llogaridhënies dhe transparencës, që shërbejnë si garanci për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës.

Referuar përmbajtjes së projektvendimit, në pikën 3, të rubrikës IV. *“Dispozita të fundit”*, Zyra e Komisionerit vëren se në fund të fjalisë, duhet fshirë togfjalëshi *“i ndryshuar”*.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, projektvendimi është konform me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit dhe shprehet dakord me miratimin e tij.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**